



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS KLINË

Numri i lëndës: 2024:003371

Datë: 12.12.2024

Numri i dokumentit: 06588871

P.nr.208/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJE-DEGA NË KLINË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Sabrije Rraci, me Bashkëpunëtores Profesionale Fatmire Elezaj, në çështjen penale kundër të pandehurve I M nga fshati D K.K për shkak të veprës penale ‘Rrezikim i trafikut publik,, nga neni 370 par.8 lidhur me par.1 dhe 6 të KPRK-së, dhe H O nga fshati K.K.K, për shkak të veprës penale ‘Rrezikim i trafikut publik,, nga neni 370 par.8 lidhur me par.1 dhe 6 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së prokurorisë Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.2403/2023 të dt.28.12.2024, pas mbajtjes se seancës publike të shqyrtimit fillestar me datë 18.11.2024, në prezencë të Prokurorit të shtetit Ramiz Buzhala nga Prokuroria Themelore në Pejë, të pandehurit I M dhe mbrojtësi i tij sipas autorizimit, av.Ardian Desku, ndërsa me datë 12.12.2024, mori dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

I M i lindur me datë në fshatin D K.K, nga babai B dhe nënës Gje gjinisë K, ku dhe tani banon, i martuar, baba i fëmijve, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion punëtor fizik, i gjendjes së mesme ekonomike, i identifikuar me numër personal, i nacionalitetit shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Më dt.5.8.2023, rreth orës 16:15 në rrugën K-S, pikërisht në fsh.K, nga pakujdesia ka shkelur nenin 53 par.1 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor të Kosovës, që ka rezultuar me lëndime të rënda trupore për të dëmtuarit E M dhe E M dhe Sh M, në atë mënyrë që ditën kritike, i

pandehuri gjersa ka qenë duke e drejtuar veturën e tij të llojit „M B,, me ngjyrë të bardhë, me targa të regjistrimit , duke mos e respektuar shpejtësin e lëvizjes e cila ishte e paraparë për atë pjesë të rrugës, me të arritur në vendin e lartë cekur derisa ishte në tejkalim e sipër , papritmas në rrugë para tij del vetura Golf, të cilin ishte duke e drejtuar i pandehuri H O i cili me të vërejtur veturën Golf, për të iu shmang aksidentit, devijon me timon duke humb kontrollin mbi veturën dhe përfundon në binarë të trenit, ku përveç dëmeve materiale, lëndime të rënda trupore kanë pësuar të dëmtuarit e lartëcekur.

-me çka ka kryer veprën penale,, Rrezikim i trafikut publik ,, nga neni 370 par.8 lidhur me par.1 dhe 6 të KPRK-së.

Prandaj gjykata në bazë të neneve: 2, 4, 7, 8, 9, 10, 17, 38, 39, 40, 42, 43,69, 70 dhe neni 370 par.8 lidhur me par.1 dhe 6 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPPRK-së:

SHPALLET FAJTOR

Konform dispozitave ligjore të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së së lartcekur, i akuzuari I M

LIROHET NGA DËNIMI

Pasi që pasojat e veprës penale e kanë goditur të akuzuarin aq rëndë, sa që dënimi do të ishte i panevojshëm për realizimin e qëllimit të tij, nenit 74 par.1 të KPRK-së, pasi që i akuzuari menjëherë pas kryerjes së veprës penale ka bërë përpjekje për evitimin ose zvogëlimin e pasojave të veprës penale, e gjithashtu në një masë të madhe e ka kompensuar dëmin e shkaktuar me atë vepër.

II.I akuzuari obligohet që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë: në emër të ekspertizës mjeko ligjore shumë prej 20 euro, në emër të ekspertizës së komunikacionit shumë prej 40.88 euro, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 euro si dhe për kompensimin e viktimave të krimit duhet të paguaj shumë prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

III.Udhëzohet pala e dëmtuar Sh M, E M E M, G M nga fsh.D K.K, që kërkesën pasurore juridike ta realizoj në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Ecuria e procedurës penale

Në këtë gjykatë, Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.2403/2023 dt. 28.12.2023, kundër të pandehurit I M, për shkak të veprës penale 'Rrezikim i trafikut publik,, nga neni 370 par.8 lidhur me par.1 dhe 6 të KPRK-së.

Gjykata fillimisht ka bërë VEQIMIN e Procedurës konform nenit 35 të KPPRK-së, për të pandehurin, H O, për të cilin ka përfunduar procedura me aktgjykim.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 11.11.2024, në të cilën kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Ramiz Buzhala, i pandehuri I M me mbrojtësin e tij av.Ardian Desku.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, Gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe duke vepruar në kuptim të nenit 242 par.4 të KPPRK-se , të pandehurit i është dhënë mundësia që të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë. Me këtë rast, Gjykata pasi e ka udhëzuar të pandehurin për rëndësinë dhe pasojat e pranimin të fajësisë në kuptim të nenit 242 par. 2 nën par. 2.1 e deri 2.4 të KPPRK-së.

I pandehuri I M ka deklaruar se e pranojë fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë pendohet për veprën e kryer, premtan që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të ngjajshme penale, më vjen keq për rastin që ka ndodh, po ashtu deklaroj se palët e dëmtuara i ka familjarë këtu e dëmtuara Sh M e kam bashkëshorte, Gj M e kam nënë, të cilat kanë pësuar lëndime të rënda, E M e kam djalë, M e kamë vajzë, dhe E M e kam vajzën e vëllaut.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit deklarohet: se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit I M, i propozon gjykatës që ta aprovojë këtë pranim të fajësisë pasi që është bërë me vullnetin e tij të lirë i vetëdijshëm për pasojat dhe përparësitë e pranimin, po ashtu ky pranim i fajësis është bërë pas konsultimit me mbrojtësin e tij, po ashtu ky pranim ka mbështetje në provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Mbrojtësi i të pandehurit av.Ardian Desku deklaron se; meqë pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, është në përputhje me provat kërkojmë nga gjykata që të bëjë pranimin e fajësis, ndërsa në momentin e vendosjes për ta dënuar apo liruar nga dënimi kërkojmë nga Gjykata që të ketë parasysh pranimin e fajësisë dhe në këtë rast ta zbatoj nenin 73 dhe 74 të KPK-së sipas të cilave i akuzuari mund të lirohet.

Vlerësimi i pranimin të fajësisë.

Në shqyrtimin fillestar dhe publik të dt.18.11.2024, gjykata pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar fajësinë nga i akuzuari I M, për veprën penale për të cilat është ngarkuar, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore nga neni 242 par 1 dhe 2 të KPRK-së. Në këtë aspekt gjykata, ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe pas njoftimit nga ana e gjykatës lidhur me benifitet dhe pasojat e pranimin të fajësisë, ka vlerësuar se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, është bindur se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë, pasi që i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, dhe pranimi i fajit mbështetet edhe në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza si dhe shkresat tjera të lëndës.

Gjendja faktike e vërtetuar

Me provat e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit I M, për shkak veprës penale ‘Rrezikim i trafikut publik,, nga neni 370 par.8 lidhur me par.1 dhe 6 të KPRK-së.

Vendimi për shpalljen fajtor

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata, ka vendosur që të akuzuarin e lartëcekur, t’u shpall fajtor por ta liroi nga dënimi, për kryerjen e veprës penale sipas aktakuzës së cekur më lart, meqenëse është vërtetuar se i njëjti palët e dëmtuara i ka anëtar të familjes, i ka nënë, bashkëshorte, dhe fëmijë, i pandehuri është godit aq rënë sa që dënimi është i panevojshëm për realizimin e qëllimit të tij. I pandehuri e ka kryer veprat penale siq edhe vet e ka pranuar sikurse në kohën, vëndin dhe mënyrën e përshkruar sikurse në dispozitiv të aktgjykimit dhe për të njëjtat është përgjegjës. Kjo për faktin se siq e ka pranuar edhe vet, i akuzuari në ditën kritike për të cilën akuzohet ka ndërmarrë të gjitha veprimet e cekura në aktakuzë.

Rrehtanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit.

Vendimi i gjykatës për ta liruar të akuzuarin nga dënimi Neni 73 i KPRK-së, në dy paragrafë përcakton se: “1. Gjykata mund ta lirojë nga dënimi, kryesin e veprës penale vetëm kur kjo shprehimisht parashihet me ligj. 2. Kur gjykata është e autorizuar me ligj që kryesin e veprës penale ta lirojë nga dënimi, ajo mund t’ia zbusë dënimin pa marrë parasysh kufizimet e parapara për zbutjen e dënimit”. Ndërsa neni 74 par.1 i parasheh situatat kur gjykata mund të lirojë të

akuzuarin nga dënimi për veprat penale të kryera nga pakujdesia, duke përcaktuar se: “1. Gjykata mund ta lirojë nga dënimi kryesin e veprës penale të kryer nga pakujdesia në rastet e mëposhtme: 1.1. nëse pasojat e asaj vepre penale e godasin kryesin aq rëndë sa që dënimi është i panevojshëm për realizimin e qëllimit të tij; ose 1.2. nëse kryesi menjëherë pas kryerjes së veprës penale ka bërë përpjekje për evitimin ose zvogëlimin e pasojave të asaj vepre dhe nëse në tërësi apo në një masë të madhe e ka kompensuar dëmin e shkaktuar me atë vepër”

Me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të akuzuarit I M, Gjykta i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësin e dënimit, sipas neneve 69 dhe 70 të KPRK-së. Në këtë aspekt, si rrethanë lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka shqiptuar dënimin për veprat penale të lartecukur, është fakti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, e që kjo rrethanë e cila duke i ndërlidh me rrethanat tjera, si fakt se i njëjti është penduar për veprën penale, dhe ka deklaruar se nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme në të ardhmën. I njëjti për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin.

Gjykata kur e liroi të pandehurin nga dënimi, u bazua në faktin se palët e dëmtuara i ka familjar, Gj Me ka nën, bashkëshorte e ka Sh M e ka bashkëshorte, E Me ka djal, dhe dhe E Me ka vajzë,

Andaj gjykata duke u bazuar në rrethanat e lartëcekura konform nenit 74 par. 1 të KPRK-së, e Shpalli Fajtor por e liroi nga dënimi.

Ndërsa, gjykata si rrethanë rënduese nuk ka gjetur. Gjykata në rastin konkret nga rrethanat e lartcekura, ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është në proporcion me peshën e veprës penale, me sjelljen dhe rrethanat e kryesit, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe përgjegjësinë e kryesit, me bindje se dënimi i tillë do të ndikoj në risocializimin dhe riedukimin e këtu të pandehurit, i cili do ta kuptoj rëndësinë e veprës penale të cilën e ka kryer dhe në këtë mënyrë i njëjti do të reflektoj që në të ardhmen mos të shkaktoj veprime të ndaluara- përkatësisht mos të kryej vepër penale, si dhe do të ndikoj tek personat tjerë të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit konform nenit 38 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës.

Vendimi për shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor është i bazuar në nenin 449 par. 2 pika 2.6 të KPPK-së, ndërkaq vendimi për pagesën në Fondin për

Kompensimin e Viktimave të Krimit është i bazuar në nenin 36 par. 3 nënpar. 3.1 të LKVK-së.

Udhëzimi i palës së dëmtuar për kërkesat pasurore-juridike

Konform nenit 462 KPPRK-së, gjykata palën e dëmtuar e udhëzon në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

Andaj, duke u mbështetur në fakte e parashtruara dhe dispozitat ligjorë nga neni 363 dhe 364 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEGA KLINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.208/2024 me datë.12.12.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale
Fatmire Elezaj

Gjyqtarja
Sabrije Rraci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, nga dita e marrjes. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate.